

VENDIM
Nr.81, datë 24.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
HIDROCENTRALET EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR
VITIN 2008**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në vendimin nr.5, datë 26.1.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike, nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2008,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi deri në datën 29 shkurt 2008 të vendimit nr.6, datë 26.1.2007 për çmimin unik të shitjes së energjisë elektrike nga të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike, nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta